



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Nr. 1824 / Prot.

Tiranë 01.07. 2020

Lënda: Përcillet për njohje dhe për zbatim Urdhëri nr.6 datë 30.06.2020 i Rektorit të UT

**Drejtuar: Fakultetit(të gjitha fakulteteve) _____
Institutit të Studimeve Evropiane
Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar
Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve Universitare
Filialit të UT, Sarandë
Administratorit të UT**

Bashkëngjitur ju dërgojmë Urdhërin nr.6 datë 30.06.2020 të Rektorit të UT “Për shpalljen e ditës së fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e përcaktuar nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për zgjedhjet e autoriteteve drejtuese dhe Senatit Akademik të UT”.

Të merren të gjitha masat ligjore nga ana juaj për fillimin e procesit zgjedhor sipas detyrave të përcaktuara në ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe në Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Tiranës”, të miratuar me Vendimin nr.5 datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT, për strukturat dhe autoritetet e ngarkuara, duke respektuar afatet e përcaktuara në to.

Në zbatim të nenit 6 dhe nenit 37 të Rregullores të sipërcituar, të njoftohet i gjithë personeli akademik dhe studentët me kohë të plotë të fakultetit tuaj për kandidimin e tyre për anëtar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve të UT dhe të Komisionit të Apelimit të UT, pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të UT, në **datat 1 -2 Korrik 2020, deri në orën 16.00 të datës 2 korrik 2020.**

Studentët që do të aplikojnë për anëtar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), aplikimi i tyre duhet të shoqërohet edhe me një vërtetim të lëshuar nga fakulteti përkatës, që vërteton që është student me kohë të plotë në atë fakultet.

Kandidatët për anëtar të Komisionit të Apelimit, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 37, pika 2 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Tiranës”.

Për arsye të situatës në të cilën ndodhemi aktualisht, të shkaktuar nga Covid -19, **aplikimi mund të bëhet edhe në rrugë elektronike, në adresën: info@unitir.edu.al.**

Bashkëngjitur modelet e formularit të vetkandidimit .

Të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana juaj për zhvillimin e këtij procesi në përputhje me rregullat e përcaktuara.

REKTORI
PROF.DR.MYNYR KONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

SEKRETARIA E SENATIT AKADEMIK

Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë

Tiranë _____ 2020

**FLETË APLIKIMI PËR ANËTAR TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË
ZGJEDHJEVE (KIZ)**

Në zbatim të nenit 6, pika 1, gërma a të Rregullores „Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës”, të miratuar me Vendimin nr.5 datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT, unë, i/e nënshkruara, z/znj. _____, personel akademik (ose student me kohë të plotë) në Fakultetin e _____ e Universitetit të Tiranës, aplikoj për të qenë anëtar e KIZ-së.

Në zbatim të nenit 6, pika 1, gërma e) të Rregullores të sipërcituar, deklaroj se nuk do të kandidoj për autoritet drejtues dhe/ose për anëtar në Senatin Akademik të UT.

Emër, Mbiemër, Firma

Shënim:

Çdo personel akademik ose student me kohë të plotë që do të vetkandidoj, duhet t’ i bashkëngjisë këtij aplikimi fotokopje të një dokumenti identifikimi, kandidati student duhet të jetë i pajisur edhe me një vërtetim të lëshuar nga autoriteti drejtues i njesisë ku studjon.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

SEKRETARIA E SENATIT AKADEMIK

Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë

Tiranë _____ 2020

FLETË APLIKIMI PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË APELIMIT (KA)

Në zbatim të nenit 37, pika 1, të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës", të miratuar me Vendimin nr.5 datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT, unë, i/e nënshkruara, z/znj. _____, personel akademik me kohë të plotë në Fakultetin e _____ e Universitetit të Tiranës, aplikoj për të qenë anëtar i KA.

Në zbatim të nenit 37, pika 2, të Rregullores të sipërcituar, deklaroj se:

- a) kam përvojë pune në mësimdhënie jo më pak se 5(pesë) vjet me kohë të plotë
- b) nuk kam qenë asnjëherë i/e dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë.

Emër, Mbiemër, Firma

Shënim:

Çdo personel akademik që do të vetkandidoj, duhet t'i bashkëngjisë këtij aplikimi fotokopje të një dokumenti identifikimi dhe një vërtetim për të vërtetuar përvojën me jo më pak se 5(pesë) vjet në mësimdhënie me kohë të plotë.

